



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 240, datë 20.4.2022

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE "BAGO",
BASHKIA KAVAJË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Bago", Bashkia Kavajë, në masën 197 156 668 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 39 431 333 (tridhjetë e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Bago", Bashkia Kavajë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit.
3. Bashkia Kavajë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Bago", Bashkia Kavajë, sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 2243/1
DATE 21.01. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAVAJË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

